

VENDIM
Nr. 53, datë 6.11.2024

PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN “MBI RAPORTIMET NË BANKËN E SHQIPËRISË SIPAS SISTEMIT RAPORTUES TË UNIFIKUAR”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja “a”, nenit 43, shkronja “c”, nenit 27, nenit 70, pika 1, dhe nenit 71 të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; nenit 47, pika 4, dhe nenit 126, pika 4, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; nenit 43, pika 3, dhe nenit 62, pika 1, shkronja “c”, të ligjit nr. 52/2016, datë 19.5.2016, “Për shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre”; si dhe nenit 18, pika 6, të ligjit nr. 55/2020, datë 30.4.2020, “Për shërbimet e pagesave”; me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes dhe Departamentit të Statistikave Financiare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Në rregulloren “Mbi raportimet në Bankën e Shqipërisë sipas Sistemit Raportues të Unifikuar”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 45, datë 10.6.2009, e ndryshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

- a) Në nenin 7, pikat 2 dhe 3, hiqet togfjalëshi “*dhe vjetore*”;
- b) Në aneksin 1 “Sistemi i unifikuar i raportimit për bankat dhe degët e bankave të huaja”, bëhen këto ndryshime:
 - i. Shfuqizohen formularët e mëposhtëm:
 - “Formulari nr. 2.DM: Formulari i raportimit të treguesve kyç të rrezikut operacional”;
 - “Formulari nr. 1.DM: Humbjet bruto sipas linjave të biznesit dhe llojeve të ngjarjeve gjatë vitit të fundit.”;
 - ii. Shtohen formularët e mëposhtëm me frekuencë tremujore:
 - “Formulari nr. 13.DM: Treguesit e paralajmërimit të hershëm”;
 - “Formulari nr. 14.DM: Regjistri i ngjarjeve të rrezikut operacional”;
 - “Formulari nr. 6/1: Informacion mbi strukturën e aksionerëve në kapitalin e bankës raportuese”;
- c) Në aneksin 2 “Sistemi i unifikuar i raportimit për subjektet financiare jobanka”, bëhen këto ndryshime:
 - i. Shfuqizohen formularët e mëposhtëm:
 - “Formulari nr. 22: Formulari i raportimit të treguesve kyç të rrezikut operacional”;
 - “Formulari nr. 1 (frekuencë vjetore) – Humbjet bruto sipas linjave të biznesit dhe llojeve të ngjarjeve gjatë vitit të fundit”;
 - ii. Shtohen formularët e mëposhtëm me frekuencë tremujore:
 - “Formulari nr. 23: Treguesit e paralajmërimit të hershëm”;
 - “Formulari nr. 24: Regjistri i ngjarjeve të rrezikut operacional”;
 - “Formulari nr.25: Informacion mbi strukturën e aksionerëve/ortakëve në kapitalin e subjektit raportues”;
- d) Në aneksin 3 “Sistemi i unifikuar i raportimit për shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre”, bëhen këto ndryshime:
 - i. Në shkronjën “a”, shfuqizohen formularët e mëposhtëm:
 - “Formulari nr. 23: Formulari i raportimit të treguesve kyç të rrezikut operacional”;
 - “Formulari nr. 1 (frekuencë vjetore) – Humbjet bruto sipas linjave të biznesit dhe llojeve të ngjarjeve gjatë vitit të fundit”;
 - ii. Në shkronjën “a”, shtohen formularët e mëposhtëm me frekuencë tremujore:
 - “Formulari nr. 24: Treguesit e paralajmërimit të hershëm”;
 - “Formulari nr. 25: Regjistri i ngjarjeve të rrezikut operacional”;

- iii. Në shkronjën “c”, shfuqizohen formularët e mëposhtëm:
- “Formulari nr. 29: Formulari i raportimit të treguesve kyç të rrezikut operacional”;
 - “Formulari nr. 1 (frekuencë vjetore) – Humbjet bruto sipas linjave të biznesit dhe llojeve të ngjarjeve gjatë vitit të fundit”;
- iv. Në shkronjën “c”, shtohen formularët e mëposhtëm me frekuencë tremujore:
- “Formulari nr. 30: Treguesit e paralajmërimit të hershëm”,
 - “Formulari nr. 31: Regjistri i ngjarjeve të rrezikut operacional”;
- e) Në aneksin 4 “Sistemi i unifikuar i raportimit për institucionet e pagesave dhe institucionet e parasë elektronike”, bëhen këto ndryshime:
- i. Shfuqizohen formularët e mëposhtëm:
- “Formulari nr. 19: Raportimi i treguesve kyç të rrezikut operacional”;
 - “Formulari nr. 21 (frekuencë vjetore) – Humbjet bruto sipas linjave të biznesit dhe llojeve të ngjarjeve gjatë vitit të fundit”;
- ii. Shtohen formularët e mëposhtëm me frekuencë tremujore:
- “Formulari nr. 23: Treguesit e paralajmërimit të hershëm”,
 - “Formulari nr. 24: Regjistri i ngjarjeve të rrezikut operacional”;
 - “Formulari nr. 25: Informacion mbi strukturën e aksionerëve/ortakëve në kapitalin e subjektit raportues”.
2. Ngarkohen subjektet e rregullores “Mbi raportimet në Bankën e Shqipërisë sipas Sistemit Raportues të Unifikuar”, me zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohen Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Departamenti i Statistikave Financiare të Bankës së Shqipërisë, për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
4. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.
- Ky vendim hyn në fuqi më 1 prill 2025.

KRYETAR
Gent Sejko